

Znj. Adelaida Hakani që prej vitit 2020 është Këshilltare Kabineti pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në vitin 2008 është diplomuar “Juriste” në Fakultetin e Drejtësisë “Luarasi”, me rezultate shumë të mira, dhe në vitin 2010-2012 ka ndjekur kurse trajnime të profilit “Business Law”, në Pace University New York, USA. Në vitin 2010 është pajisur me licencën e Avokatit, pranë Dhomës së Avokatisë, Tiranë. Në vitin 2018 ka ndjekur studimet “Master”, profili “Business Law”, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në periudhën 2008-2010 ka punuar si specialiste pranë Departamentit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Integritetit Europian. Në periudhën 2013- 2014, ka punuar si avokate pranë Studio Ligjore “Hakani & Associates”. Gjatë periudhës Janar 2014 deri në Qershor 2020, ka punuar në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës. Gjatë eksperiencës profesionale 8-vjeçare znj. Hakani ka kryer trajnime, Intership dhe seminare brënda dhe jashtë vendit, kryesisht për çështje të hartimit të programeve si dhe të objektivave të zhvillimit të sektorit hidrokarbur, etj. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe gjuhën italiane.